

2029
14.12.2020



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E SHËNDETËSISË DHE MBROJTJES SOCIALE

ZËVENDËSMINISTËR

Nr. 5133/Prot.

Tiranë, më 10/12/2020

Lënda: Kthim përgjigje

INSTITUTIT TË EKSPERTËVE KONTABËL TË AUTORIZUAR TË SHQIPËRISË ✓

Adresa: Rruga e Elbasanit, Pallati Edil A-it, pranë Ambasadës Amerikane, P.O.B 1437, Tiranë

Në përgjigje të shkresës suaj nr. 361 Prot, datë 17.11.2020, të regjistruar në Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale me nr. 5133 Prot, datë 17.11.2020, nëpërmjet së cilës kërkohet miratimi për të realizuar Asamblenë e Përgjithshme të Anëtarëve, në ambientet e Pallatit të Kongreseve, ju bëjmë me dije si më poshtë vijon:

Në pikën 1, të Urdhrit Nr. 633, datë 17.11.2020 “Për ndalimin e grumbullimeve në vende të mbyllura apo të hapura”, është përcaktuar se ndalohen grumbullimet me më shumë se 10 persona në vende të mbyllura apo të hapura.

Duke vlerësuar situatën epidemiologjike në vendin tonë me rrisht të shtuar për shkak të rasteve të reja me infeksionin Covid-19, aktualisht nuk është e mundur miratimi i lejës për organizimin e Asamblesë së Përgjithshme të Anëtarëve në ambientet e Pallatit të Kongreseve, për shkak të rrezikshmërisë që paraqesin aktivitete të tilla në përhapjen e infeksionit Covid-19.

Duke ju falenderuar për mirëkuptimin,

ZËVENDËSMINISTËR

Mira Rakacolli

